

Në kuadër të nismws "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave: Çelësi i suksesit në politikat e ndërmarrë -dhe përfshirja e të rinjve" me mbështetjen e UnWomen Albania, Observatori për të Drejtat e Femijëve, realizoi disa aktivitete në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore. Në bashkëpunim me nxënës të shkollave të mesme "Abdulla Keta" dhe "Petro Nini Luarasi", U realizua një ekspositë me vizatime të ndryshme. Kjo ekspositë u prezantua pikërisht në datën 25 Nëntor, që përkon me ditën e ndërkombëtarë të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Objektivat e Ekspozitës:

Të angazhohen të rinjtë (djem dhe burra) në fushën e dhunës kundër vajzave dhe grave.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin përfaqësueses nga shkolla pritëse "Abdulla Keta, Drejtoresha e shkollës "Abdulla Keta" nxënës nga shkolla "Abdulla Keta", mxënës nga shkolla "Petro Nini Luarasi", Mësues dhe psikologe të dy shkollave Advokacy voice , Z. Erald Bakalli zv rektor Universiteti i Arteve Tiranë, përfaqësuar Observatori për të Drejtat e Femijëve.

Gjatë aktivitetit nxënësit u njohtën më punimet e njëri tjetrit mbi tematikën e dhunës dhe barazisë gjinore.

Një muaj me parë nxënës ng atë dy shkollat e përzgjedhura si pjesë e fushatës morrën pjesë në një trajnim mbi fushatën tematikat e dhunës me bazë gjinore.

Gjatë trajnimit nxënësit u njohtën me termat e ndryshme: barazi gjinore, gjini, stereotip, trajtim i barabartë etj. Çështjet e diskutimit u orientuan në temat e dhunës në familjë, dhuna ndaj moshtarave, dhuna në komunitet.



ESE MBI FENOMENIN E DHUNES DHE BARAZISE GJINORE

Dhuna, pjesë e së shkuarës dhe pér fat të keq vazhdon të jetë fenomen i së tashmes. Gjithsecili duhet të bëjë diçka tanë në mënyrë që ajo të mos jetë seriart problem në të ardhmen. Të dhunosh do të thotë të ngresh dorë, të godasësh, apo të shtysë fizikisht. Dhunë gjithashtu do të thotë edhe të ngresh zërin, të bertasësh, të ushtrosh presion dhe të kufizosh lirinë e një personi. Dhuna, shfaqet në forma të ndryshme dhe le plaqë të mëdha te individet e prekur prej saj. Plaqët mund të janë fizike, mendore, shpirtërore, emocionale apo psikologjike. Plaqët fizike dhembin njehërë por shërohen dhe zhduken me kallimin e kohës, ndërsa plaqët psikologjike mbeten gjithmonë aty, të dhembin sa herë i prek, nuk shërohen. Ato të shoqerojnë gjatë gjithë jetës. Dhuna nuk justifikohet. Nuk e bën se je nën efektin e pijeve alkollike apo sepse je i stresuar. Disa dhunojnë pér të nxjerrë të gjithë shqetësimet, problemet, streset që u jep jeta. Përparrë se të dhunosh duhet të mendosh se ajo nuk zgjidh asnjë, por përkundrasi hap një problem të ri. Ajo e shkatërron jetën e njerëzve. Të gjithë duhet të ndërgjegjësohemit të ndalojmë dhe t'i themi stop çdo forme të dhunes!

Megi Mara

Shkolla "Abdulla Keta"



Shpeshhere dégjojmë termin "barazi gjinore". Shpeshhere dégjojmë të flitet pér të. Dégojmë të flitet pér gratë si të barabarta me burrat. Se si ato gjithnjë e më shumë po marrin një rol dominues në shoqëri. Por në të vërtetë sa të barabartë janë gratë me burrat? Është e vërtetë që situata vitet e fundit ka ndryshuar në favor të grave. Gjithandjej në ekrane, kompani, apo institucionë të tjera po shohim se grave ju është lënë një hapesire më e madhe. Gratë tanë po luajnë një rol të rendësishëm në jetën e përditshme, si në aspektin professional ashtu edhe në aspektin privat. Gjithnjë e më shumë po vihet re dëshira dhe siguria që kanë në vetvete pér të ecur përparrë në jetë me këmbët e tyre. Por, përvèc kësaj ka edhe të tjerë të cilet këtë rol të femrës e shikojnë si një cenim të pozitës apo rolit që meshkujt, gjoja sekxi dominant, u takonë me të drejtë. Ata nuk bëjnë gjë tjeter vecse ndrydhin rolin e femrës duke e bërë atë në disa raste të varur dhe të pasigurt. Në shumë vende femra nuk paguhet njësoj si mashkulli e në shumë të tjera nuk ka arritur as të drejtën e votimit dhe duhet thjesht të qëndrojnë në shtëpi duke u kujdesur pér shtëpinë, femijët dhe familjen. Siç e thasë në fillim femra gjithnjë e më shumë po behet e barabartë me mashkullin, por duhet të shtoj se përsëri femra nuk është dhe nuk do te jetë e barabartë me mashkullin vetëm prej mentalitetit që i rrëthon njerezit gjithandjej. Prandaj nese duam me të vërtet të bëjmë një ndryshim duhet që ta nisim nga vetja jonë.

Shkolla "Abdulla Keta"

